



## SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, JANAR, 2025

1. Nxënësi/nxënësjja \* merr **1 pikë** nëse ka rrethuar saktë: *3. udhëzues*
2. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Që të ketë besim sublim te vetvetja, sepse atëherë ai do të ketë gjithmonë besim sublim në njerëzimin dhe në ZOTIN*
3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *të merrni përdore, ta mësoni për gjërat, por butësisht, nëse mundeni*
4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka plotësuar : *Atij do ti duhet të mësojë... se jo të gjithë njerëzit janë të drejtë, dhe jo të gjithë njerëzit janë të sinqertë.*
5. Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka rrethuar saktë: *mbiemri....shumë më tepër, shkalla sipërore.*  
  
Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë vetëm njëri përgjigje të saktë
6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *realizmit (evropian)*
7. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar: *1. Studimet për zakonet*
8. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *për etjen dhe para, dhe të ngjashme në këtë kuptim*
9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Nga dashuria për të bijat*
10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *sonet*
11. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rendit:  
*Qytetërimet: sumer, egjiptian, sanskrit, greko-romak*
12. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *motiv i dashurisë*
13. Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka plotësuar: *Qiejt e ngrysur – epitet*  
dhe se i referohet: *humbjes së dashurisë*  
  
Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë ose figurën letrare ose atë që i referohet.

---

\*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi



- 14.** Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar: *Po ka një ndryshim. Vargu është: Dhe unë për ty seç ndjeva mall. Lidhëza dhe (shtuese) krijon idenë e përmbylljes së diçkaje. Tregon se mendimi është përmbyllur. Pra, gjithçka është e mbyllur për heroin, ka mbetur vetëm malli.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse shpjegon domethënien e këtij ndryshimi, tregon ndryshimin midis vargjeve.

- 15.** Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka veçuar: *është viktimë dhe nëse ka argumentuar se është viktimë e librave romantikë/ kalorsiak që ka lexuar*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë vetëm një përgjigje ose veçuar se është viktimë ose pjesën e argumentimit.

- 16.** Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka rrethuar: *2 e vërteta hyjnore dhe ligji tokësor* dhe ka argumentuar përgjigjen nën A se: Subjekti i romanit ka në qendër një krim, autori na tregon se krimi, çfarëdo arsyeje që të ketë, është krejtësisht i pa justifikueshëm dhe i pafalshëm (*dhe përgjigje të përafërta në përkufizim*)

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar saktë alternativën nën 2, ose e ka argumentuar saktë atë.

- 17.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *metamorfoza*

- 18.** Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka sqaruar kuptimin e fjalës: *sovran – mbret* dhe ka shkruar saktë figurën letrare: *metafora*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë vetëm njërin përgjigje të saktë ose nën A ose nën B.

- 19.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar *2. pjesëz e diatezës joveprore*

- 20.** Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar:  
Rrethanori: *aty – këtu / ngadalë*  
Lloji: *vendi / mënyre*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka gjetur rrethanorin por nuk e ka treguar saktë llojin e tij ose të kundërtën.

- 21.** Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar:  
e kryefjalës (*dyshimi*), të përcaktorëve (*i zi / për njerëzit*),  
kallëzuesit (*do të ulet*), të rrethanorëve (*gjithmonë, mbi ballin tim*).



Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë 3 përgjigje të sakta.

**22.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar **të vdekurit i ngjalle,**

**Të gjallët i vdiqe fare** janë:

*Antonime dhe kundërvënie ndërmjet sende a dukurive.*

**23.** Nxënësi merr 2 pikë nëse gjen të gjitha gabimet:.

Radio **T**elevizioni **S**hqiptar fton të gjithë krijuesit dhe interpretuesit të marrin pjesë në konkurrim për të qenë pjesëmarrës në **F**estivalin e 59-**të** të **K**ëngës. Përzgjedhja e këngëve pjesëmarrëse do të kryhet nga komisioni i seleksionimit të këngëve në bazë të dëgjimit të tyre. **K**onkurrentët duhet të dorëzojnë pranë stafit të festivalit në **R**adio **T**irana ose në postën elektronike festival@rtsh.al këngën e plotë me të gjitha specifikimet teknike si më poshtë.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse gjen shtatë gabime.

**24. Skema e vlerësimit të tekstit funksional**

<b>FORMA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT</b> <b>3 pikë</b>	<b>GJUHA</b> <b>3 pikë</b>	<b>STILI</b> <b>2 pikë</b>
Të gjitha të dhënat e shkruara në udhëzim janë renditur sipas parimeve të hartimit të tekstit. <i>3 pikë</i>	Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. <i>3 pikë</i>	Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i>
Të gjitha të dhënat janë renditur mirë, por mungon ndonjë e dhënë që e vështirëson kuptimin e tekstit, përkatësisht elementi kryesor që nuk e përmbys formën e tekstit. <i>2 pikë</i>	Norma drejtshkrimore dhe gramatikore pjesërisht është respektuar, por ka lëshime si: - përdorimi i shenjave të pikësimit - përdorimi i drejtë i pjesëve gramatikore <i>2 pikë</i>	Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i>
Mungojnë shumë të dhëna, por teksti kuptohet. <i>1 pikë</i>	Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht: - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit	Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të



<p>Nuk është respektuar forma e dhënë ose përmbajtja e tekstit është e pakuptueshme. <i>0 pikë</i></p>	<p>(p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <b>dhe/apo</b> - gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></p> <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>	<p>papërfunduar... <i>0 pikë</i></p>
--	---	--

## 25. Skema e vlerësimit të esesë:

**"Procesi" F. Kafka**

### **Përmbajtja 7 pikë**

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shkruan tiparet themelore të autorit, thekson se është roman në të cilin me të drejtë thuhet se njeriu i bën gjyqin vetvetes, është absurd etj... <i>(1 pikë)</i></li> <li>- Heroi është Jozef K. i cili nuk e di për se akuzohet, është viktimë e sistemit, një akuzë kundër sistemit shoqëror burokratik... <i>(1 pikë)</i></li> <li>- fati tallet me të, akuzohet dhe dënohet me vdekje, pa e ditur deri në fund akuzën, madje këtë nuk e</li> </ul>
--	--



	dinin as vetë gjyqtarët, ...(1 pikë) <i>Gjithsej 3 pikë</i>
Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...	Krijimi i tekstit: - qasja origjinale/ kreative ndaj temës (1 pikë) - përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë) - argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë) <i>Gjithsej 4 pikë</i>

### **Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë**

<b>GJUHA 3 pikë</b>	<b>STILI 2 pikë</b>	<b>FORMA GRAFIKE E TEKSTIT 1 pikë</b>
<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. <i>3 pikë</i></p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë: - përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore <i>2 pikë</i></p> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht: - nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore - gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura <b>dhe/apo</b> - gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) <i>2 pikë</i></p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>0 pikë</i></p>



<p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.</p> <p><i>0 pikë</i></p>		
---	--	--

**Skema e vlerësimit të esesë:**

**Shih botën brenda një zemre**

***Përmbajtja 7 pikë***

<p>Respektimi i kërkesave të dhëna</p>	<p>Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Shprehin mendimin e vet rreth temës dhe kuptimit që shpreh fjala zemër, për ndjenjë ndaj njeriut, ndaj atdheut etj. (1pikë)</li> <li>- Shprehin lidhjen e fortë me diçka që adhuron, dëshiron, ndjen etj. (1pikë)</li> <li>- Shprehin mendimin ndaj ndërgjegjshëmrisë së njeriut ndaj botës etj. (1pikë)</li> </ul> <p><i>Gjithsej 3 pikë</i></p>
<p>Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë...</p>	<p>Krijimi i tekstit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- qasja origjinale/ kreative ndaj temës (1 pikë)</li> <li>- përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë)</li> <li>- argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës (1 pikë)</li> <li>- argumentimi me fakte dhe qëndrime personale (1 pikë)</li> </ul>

**Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë**

<p><b>GJUHA</b> <b>3 pikë</b></p>	<p><b>STILI</b> <b>2 pikë</b></p>	<p><b>FORMA GRAFIKE E</b> <b>TEKSTIT</b> <b>1 pikë</b></p>
<p>Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. <i>3 pikë</i></p> <p>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore <i>2 pikë</i></li> </ul> <p>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore</li> <li>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura</li> </ul> <p><b>dhe/apo</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- gabon në përdorimin e parafjalëve... <i>1 pikë</i></li> </ul> <p>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores ë, nuk</p>	<p>Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit. <i>2 pikë</i></p> <p>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave. <i>1 pikë</i></p> <p>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara... <i>0 pikë</i></p>	<p>Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi) <i>2 pikë</i></p> <p>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi). <i>0 pikë</i></p>



<p>zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja <i>j</i>, gabon në përdorimin e trajtës mohuese. <i>0 pikë</i></p>		
---	--	--